

Raport për rezultatet e konsultimeve publike

1. Titulli i draft aktit

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 74/2014, “Për armët””

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 74/2014, “Për armët”” është hartuar nga nga Drejtoria e Programimit, Standardizimit, Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore për Çështjet e Brendshme, në Ministrinë e Brendshme. Projektligji është dërguar për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrinë e Mbrojtjes, në muajin dhjetor 2022.

Konsultimi publik në RENJK për periudhën kohore në respektim të ligjit, nga data 23 dhjetor 2022 deri më datë 24 janar 2023.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguron informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitetet nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit të përdorura për **projektligjin** “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 74/2014, “Për armët”” ishin dy:

1. Konsultimi elektronik, përmes Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet, RENJK për periudhë të paktën 20 ditë pune sipas ligjit, duke filluar nga data 23 dhjetor 2022 deri më 24 janar 2023.
2. Email.

4. Palët e interesit të përfshira

Palët e interesuara të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike gjatë procesit të hartimit, janë:

Ka dhënë kontributin e saj Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore Për Çështjet e Brendshme, përkatësisht:

Drejtorja e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në MB;

-Koordinatori për konsultimin në MB, për mbledhjen e komenteve nëpërmjet RENJK.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

| <i>Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</i> | <i>Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</i> | <i>Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</i> | <i>Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)</i> | <i>Justifikimi</i> |
|--|---|--|--|--------------------|
| | | | | |